

SIGURTË NË SHKOLLË, NË SHTËPI DHE ME SHOKË

DORACAK PËR FËMIJËT
MBI SIGURINË



OSCE Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo



Ky doracak është përpiluar nga Policia në Bashkësi në kuadër të Policisë së Kosovës dhe botohet me mbështetjen e OSBE-së.

Të nderuar fëmijë, prindër, kujdestarë dhe mësimdhënës:

Synimi i përgjithshëm i doracakut për siguri është që të mbrojë fëmijët nga mjediset e pasigurta, duke iu siguruar udhëzime dhe këshilla.

Ky doracak u dedikohet fëmijëve, prindërve dhe mësimdhënësve, dhe përfshinë këshilla se si të veprojnë në situata të ndryshme, në mënyrë që fëmijët të jenë të sigurt.

Policia e Kosovës është e përkushtuar që përmes projekteve të komunitetit t'iu ndihmojë fëmijëve dhe të rriturve në përmirësimin e sigurisë nëpër shkolla, shtëpi dhe vende tjera.



SIGURIA PERSONALE



KUR GJENDENI JASHTË SHTËPISË

[Këshilla për fëmijë]

- Tregoni të afërmve ku jeni duke shkuar, me kë jeni duke shkuar dhe kur pritet që të ktheheni;
- Në rast se ndonjë i panjohur ju ofrohet dhe insiston të flasë me ju, informoni anëtarët e familjes dhe policinë;
- Në rast se dikush ju ndjekë, vraponi për në shtëpi ose për në vendin publik më të afërt dhe kërkoni ndihmë me zë (të lartë);
- Nëse dikush ju kërcënon, tregoni prindërve, drejtorëve të shkollave, kujdestarëve të klasës ose policisë;
- Gjithmonë qëndroni në shoqëri të shokëve/shoqeve, (gjatë udhëtimeve) mos ecni ose luani vetëm;
- Mos iu përgjegjini ftesës së të panjohurve për të shkuar ndokund;
- Mos flisni dhe mos udhëtoni me të panjohur;

SIGURIA NË SHTËPI

[Këshilla për fëmijë]

- Në rast se pranoni thirrje telefonike nga ndonjë i panjohur, mos i tregoni që jeni vetëm në shtëpi;
- Mos i ftoni të panjohurit në shtëpi;
- Mos ia hapni derën të panjohurve, nëse jeni vetëm në shtëpi;
- Keni kujdes kur i përdorni veglat shtëpiake, përdorni ato vetëm në prani të të rriturve;
- Siguroni që t'i keni numrat e anëtarëve të familjes suaj;
- Mbani numrin e policisë **192** (për thirrje nga telefonat mobil) ose **92** (nga numrat fiks), ose email adresën: info@kosovopolic.com



**SIGURIA
PERSONALE**

TË SIGURT NË SHKOLLË, SHTËPI
DHE ME SHOKË

REAGIMI I DUHUR NË RASTET E VJEDHJES

[Këshilla për fëmijë, prindër/kujdestar dhe mësime dhënë]

Keni parasysh rëndësinë e sigurisë tuaj personale:

- Përpiquni të mbani mend sa më shumë hollësi që të jetë e mundur për pamjen e personit, i cili është përfshirë në vjedhje (p.sh. mosha, pesha, gjatësia, tatuazhet, pamja ose ndonjë lëndim ose shenjë tjetër) dhe drejtimin në të cilin është larguar i dyshuari, mos e ndiqni këtë person ose mos ndërmerrni ndonjë veprim vetë;
- Mundësisht shkruani tabelat e regjistrimit të veturës;
- Menjëherë thirrni policinë! **192** (me telefon celular) ose **92** (me telefon fiks);
- Kur ta paraqitni rastin në polici, lëroni emrin tuaj, numrin e telefonit dhe adresën e vendit ku ka ndodhur vjedhja. Policia do të sigurohet që ju të jeni të sigurt.

RAPORTIMI I INCIDENTEVE PËRMIRËSON SIGURINË TUAJ

SIGURIA GJATË PUSHIMEVE

[Këshilla për fëmijë]

SHKUARJA NË SHETI:

- Tregoni prindërve se jeni duke shkuar, me kë jeni duke shkuar dhe kur pritet të ktheheni;
 - Qëndroni bashkë me grupin tuaj;
 - Shmanguni nga takimi me të panjohur në zona të panjohura dhe të izoluara;
 - Silluni dhe luani vetëm në vendet që i njihni prej më parë;
 - Mos ndizni zjarre;
 - Nëse vëreni ndonjë zjarr informoni prindin/ose mësimdhënësin tuaj;
 - Mos leni mbeturina prapa vetes, hidhni ato në kontejnerin e mbeturinave.
- Kontribuoni për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm! Mbeturinat mund t'i tërheqin shtazët dhe në këtë mënyrë ta rrezikojnë sigurinë tuaj.

FËMIJËT DHE PËRDORIMI I INTERNETIT

[Këshilla për fëmijë, prindër/kujdestar dhe mësimdhënëses]

Ka shumë gjëra të panjohura në lidhje me sigurinë në internet dhe përdorimin e tij. Fëmijët, të cilët e përdorin internetin për qëllime arsimore dhe argëtuese kërkohen të marrin parasysh kurthet e mundshme që janë brengosëse kur flasim për sigurinë dhe mirëqenien e tyre

- Mos jepni informata personale në internet;
- Mos dërgoni fotografi ose video xhirimet tuaja- as mos pranoni të tilla nga të tjerët;
- Mos i hapni mesazhet e dërguara me postë elektronike nga adresat e panjohura;
- Keni kujdes kur të komunikoni. Komunikoni vetëm me njerëz që i njihni
- Raportoni mesazhet te prindërit dhe policisë.

**SIGURIA
PERSONALE**

TË SIGURT NË SHKOLLË, SHITËPI
DHE ME SHOKË

SIGURIA NË KOMUNITET



LARMIA, PRANIMI

[Këshilla për prindër dhe mësimdhënës]

Secili fëmijë duhet ta gëzojë të drejtën që të rritet dhe zhvillohet në mjedis të sigurt dhe të qetë. Fëmijët dallojnë nga njëri tjetri në bazë të gjuhës që flasin, pamjes fizike, gjinisë, racës, aftësive dhe shkathtësive, religjionit, përkatësisë kombëtare. Kjo larmi vetëm se e pasuron dhe plotëson komunitetin si tërësi. Flisni me fëmijët tuaj për larminë në shoqëri dhe inkurajoni ata që të jenë pjesë e kësaj larmie. Të gjithë së bashku mund të bëjmë ndryshime pozitive në shoqëri.

[Këshilla për fëmijë]

Fëmijët janë të ndryshëm; ju jeni të ndryshëm nga shokët tuaj;

- Ndhmoni shokët, të cilët kanë nevojë për ndihmën tuaj për shkak se ai/ajo flet gjuhë tjetër nga ajo e jotja;
- Nëse një shok kërkon ndihmën tuaj, kontaktoni mësimdhënësin ose drejtorin e shkollës dhe ndihmoni shokun tuaj;
- Nëse e shihni që shoku juaj është goditur fizikisht nga të tjerët, thirrni menjëherë mësimdhënësin ose drejtorin e shkollës. Nëse jeni jashtë hapësirës së shkollës ose shtëpisë, thirrni në telefon policinë në 192 ose 92 (me numrin fiks).



**SIGURIA NË
KOMUNITET**

TË SIGURT NË SHKOLLË, SHTËPI
DHE ME SHOKË


VIZATIMET/GRAFITET E PAHIJSHME

[Këshilla për fëmijë, prindër/kujdestar dhe mësime të mësuara]

Vizatimet/grafitet e pahijshme kanë ndikim negativ në komunitetin në shumë mënyra, duke përfshirë:

- Përmbajtja e vizatimeve dhe grafitëve mund të jetë ofenduese për njerëzit tjerë;
- Ato mund ta dëmtojnë imazhin e qytetit tuaj;
- Vizatimet e tilla shkaktojnë shpenzime të larta dhe të panevojshme për pastrimin e tyre.

Shkrimi i vizatimeve dhe grafitëve që kanë për qëllim të përcjellin një mesazh edukativ dhe/ose argëtues, lejohet vetëm me marrjen e lejes nga autoritetet kompetente, ose në rast se është pronë private, duhet të merret pëlqimi nga pronari.



DHUNA NGA BASHKËMOSHATARËT

[Këshilla për fëmijë, prindër/kujdestar dhe mësime dhënë]

Nëse ju afrohen shokët e shkollës dhe ju ofendojnë, ju shajnë ose ju kërcënojnë, ose nëse kërcënoheni nga fëmijët tjerë, të cilët nuk janë të shkollës suaj, por kanë ardhur nga jashtë, gjithmonë:

- Informoni menjëherë shokët që i keni afër;
- Informoni prindërit tuaj.

Nëse incidenti ndodh brenda objekteve të shkollës dhe/ose në oborr të shkollës, atëherë kontaktoni dhe informoni:

- Drejtorin e shkollës, arsimtarin/profesorin;
- Kërkoni ndihmë nga shokët tuaj.

Mos harroni:

Thirrni policinë në **192** (me telefon celular) ose **92** (me telefon fiks).

**RAPORTIMI I RASTEVE TË
KËRCËNIMEVE DHE NGACMIMEVE
NDIHMON POLICINË NË
KOMUNITET TA LUFTOJË ATË
FENOMEN!**

**SIGURIA NË
KOMUNITET**

TË SIGURT NË SHKOLLË, SHTËPI
DHE ME SHOKË

SIGURIA NË KOMUNIKACION



1. KËMBËSORËT NË KOMUNIKACION

Është rregull i përgjithshëm që këmbësori duhet të lëvizë dhe të qëndrojë vetëm në zonat e caktuara për këmbësorë.

Këmbësorët duhet të ecin në rrugët, që janë të caktuara për këmbësorë, që mund të jenë trotuare. Nëse nuk ka trotuar ose rrugë të shtruar për këmbësorë, ata duhet ta mbajnë anën e majtë të rrugës, në mënyrë që të mund ta shohin komunikacionin që vjen drejt tyre. Nëse janë në grupe, këmbësorët duhet të ecin njëri pas tjetrit.

- Fëmijët e shoqëruar nga prindërit e tyre gjithmonë duhet të ecin në anën e sigurt të rrugës, duke iu shmangur kështu anëve të rrugës afër trafikut.
- Në vendet ku komunikacioni është i rregulluar me semaforë, këmbësorët duhet t'i respektojnë ato rregulla. Kalimi i rrugës lejohet vetëm kur ndizet drita e gjelbër për këmbësorë. Kur kalohet rruga nga njëra anë në tjetrën, rregulla e përgjithshme është që këmbësorët duhet të kontrollojnë/vëzhgojnë të dy anët e rrugës, së pari anën e majtë e pastaj të djathtë.
- Kur këmbësorët e kalojnë hekurudhën, gjë që duhet të bëhet me kujdesin më të madh, nuk duhet të kalohet mbi binarë nëse drita e kuqe është e ndezur, ose nëse pengesa është e lëshuar.



2. SEMAFORËT

Semaforët shërbejnë për rregullimin e komunikacionit në udhëkryqe dhe vende tjera. Semaforët e rregullojnë qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve.

Lëvizja e këmbësorëve rregullohet me dritën e kuqe dhe të gjelbër.

- **DRITA E KUQE** | ndalohet kalimi i rrugës
- **DRITA E GJELBËR** | lejohet kalimi i rrugës

Mos e kaloni rrugën madje edhe nëse drita e gjelbër është e ndezur, pa shikuar gjithmonë në mos po ju afrohet ndonjë automjet.

3. JU DHE BIÇIKLETA JUAJ

[Këshilla për fëmijë]

Ngasësit e biçikletave duhet ta ngasin atë sa më afër që të jetë e mundur anës së djathtë të rrugës, dhe nëse është i caktuar shtegu për biçikleta, atëherë ngasësit e biçikletave duhet të ngasin nëpër atë shteg.

MBROJTJA NGA LËNDIMET

- Bëhuni çiklist i kujdesshëm;
- Përdorni helmetën;
- Në mbrëmje, biçikleta duhet të ketë dritën e bardhë përpara dhe dritën e kuqe prapa;
- Në mbrëmje, vishni rroba më shkëlqim në mënyrë që të jeni të dukshëm nga të tjerët (jelek fluoreshentë-dritëlëshues)
- Beni më shumë kujdes kur gjendeni në kryqëzime të trafikut;
- Përpuni që të ngisni një metër larg nga skaji i rrugës, shikoni përpara dhe shmangni rreziqet si gropat, kanalizimet ose pargjet e mbeturinave;
- Para se të ktheheni djathtas ose majtas ose kur ta ndërroni korsinë, sinjalizoni duke e ngritur dorën për të treguar drejtimin e lëvizjes suaj
- Kushtoni vëmendje semaforëve, që e rregullojnë trafikun. Semaforët që e rregullojnë trafikun për biçikleta dhe vetura, kanë tri ngjyra: të kuqen, të verdhën (portokalltën) dhe të gjelbrën.


• **DRITA E KUQE** | nuk lejohet lëvizja;

• **DRITA E GJELBËR** | lejohet lëvizja;

• **DRITA E VERDHË (PORTOKALLTË)** | keni kujdes, mos lëvizni derisa të shihet drita e gjelbër.

Nëse ndizet drita e kuqe, mos lëvizni derisa të shihet drita e gjelbër. Nëse ndizet drita e kuqe, mos lëvizni dhe pritni dritën e gjelbër. Gjithmonë qëndroni vigjilent! Keni kujdes dhe shikoni nëse ka lëvizje të automjeteve edhe nëse është drita e kuqe.

SIGURIA DHE SHËNDETI



1. PIRJA E DUHANIT

Pirja e duhanit shkakton shumë sëmundje kronike, mund të shkaktojë invaliditet dhe vdekje të parakohshme.

Pirja e duhanit mund të shkaktojë refuzimin dhe largimin e shokëve.

PASOJAT NGA PIRJA E DUHANIT:

- Rënia e imunitetit;
- Mungesa e motivit për mësim dhe argëtim;
- Pasoja negative në zhvillim fizik dhe psikologjik;
- Sëmundje serioze.

**PIRJA E DUHANIT ËSHTË E
RREZIKSHME PËR SHËNDETIN
TUAJ! QËNDRO LARG NGA
CIGARET DHE DUHANPIRËSIT.**

2. SUBSTANCAT NARKOTIKE

Konsumimi i narkotikëve fillon nga kërsëria, nga dëshira për tërheqjen e vëmendjes së shoqërisë, ose nga dëshira për të iu shmangur realitetit, duke mos menduar për pasojat.

DROGA VRET, NUK FAL!

Mos u bëni viktimë e kuriozitetit ose miqësisë me njerëz të papërgjegjshëm, viktimë e shitësve ose përdoruesve të narkotikëve. Mos harroni, konsumimi i narkotikëve krijon varësi, që rezulton në shumë pasoja për ju, familjen dhe miqtë tuaj.

PASOJAT NGA KONSUMIMI I NARKOTIKËVE:

- Mungesa e koncentrit dhe aftësisë për të menduar dhe mësuar;
- Anoreksia;
- Përsheptimi i frymëmarrjes;
- Humbja e kontrollit, hutimi gjatë të folurit;
- Zhvillimi i sëmundjeve infektive, siç është hepatiti;
- Humbja e peshës, lodhja dhe depresioni;
- Humbja e bukurisë natyrale dhe zhvillimi i sëmundjeve të lëkurës;
- VDEKJA!

**Thuaji 'PO' jetës së (lumtur),
Thuaji 'JO' drogës...**

osce Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo



Ky doracak është përpiluar nga Policia në Bashkësi në kuadër të Policisë së Kosovës dhe botohet me mbështetjen e OSBE-së.

TË DASHUR FËMIJË:

Ky doracak është përmbledhje e porosive që kontribuojnë në mirëqenien tuaj.

PRANDAJ MOS HARRONI:

Për një fëmijëri të lumtur përmbajuni porosive të këtij doracak!

